



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 440/2014

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazic dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Adem Salihaj nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me date 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë :

#### VENDIM

**I. Miratohet** si e bazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Adem Salihaj nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ti rinumëroi vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit politik LDK në Vendvotimin (VV) 2504D/01R.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit të VV si në pikën –II- të këtij diapozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjekti politik LDK dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se komisionari Meridian Tmava nga subjekti politik LDK nuk e ka shënuar numrin e votave të kandidatit Adem Salihaj me nr.23 ne Formularin e Rezultati të Kandidatit (FRK). Me kete rast parashtruesi i ankeses kërkon qe te behet rinumerini i votave ne kete kuti votimi me numër 2504D/01R.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e anëtarit të komisionit të QV me nr. 2504D/01R, Meridian Tmava.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

### **ankesa është e bazuar**

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati Adem Salihaj nga subjekti politik LDK në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon në ankesën e tij se është dëmtuar nga mos procedimi i votave në FRK nga ana e komisionarëve të VV 2504D/01R.

Nga ekipi i PZAP-it është konstatuar se kutia e votimit me nr. 2504D/01R për Komunën e Ferizajt ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të kutisë kanë nr.119723, 119721, 119724 dhe 119722 ndërsa shiriti i mesëm nr. 095115 i cili nuk ishte i prekur fare. Shiriti brenda kutisë votimit kishte nr. 095119.

Në vazhden e hetimit, ekipi i PZAP-it ka konstatuar se nga origjinali i FRK-së që gjendet në QNR, kandidati me nr 23 nga radhët e subjektit politik LDK nuk posedon asnjë votë, ndërsa pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutinë e votimit 2504D/01R del se janë 47 fletëvotime të vlefshme të kandidatit në fjalë. Këto fletëvotime janë rinumëruar në QNR dhe të njëjtat nuk janë fotokopjuar nga ana e hetuesve të PZAP-it.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe nga deklaratat e anëtarit të KVV se është bërë gabim i paqëllimshëm gjatë plotësimit të FRK-së në QV 2504D/01R në Komunën e Ferizajt del se ka pasur një lëshim gjatë plotësimit të FRK-së në VV e cekur më lartë, me ç'rast numri i votave të kandidatit Adem Salihaj nuk ishin përfshirë në rezultatet përfundimtare të shpallura nga ana e KQZ-së

Nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura është vendosur si në dispozitiv në bazë të nenit 115.1, 117.4 të LZP-së, dhe nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 440/2014 më datën 30.06.2014



**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha.**

***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*